



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.41/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Nenad Laziq dhe Adnan Konushevci anëtarë, me zyrtaren ligjore, Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, për shkak të vendosjes së posterve në objekt publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 06.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

LEJOHET tërheqje e ankesës së Koalicionit PDK-AAK-NISMA, Anr.41/2017 06.06.2017.

Arsyetim

Koalicionit PDK-AAK-NISMA, ka paraqitur ankesë në PZAP kundër Koalicionit LDK-AKR, për shkak të vendosjes së posterve në objektet publike në afërsi të shkollës fillore “Afrim dhe Fahriu” për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Pasi që ankesa ka qene e paqarte, PZAP-i ka kërkuar nga parashtresuesi i ankese qe te beje plotësimin e ankesës.

Me datë 04.06.2017 ankuesi ka parashtuar kërkesë për tërheqjen e ankesës me numër: Anr. 41/2017, duke u bazuar në faktin se Koalicionit PDK-AAK-NISMA nuk ka prova shtesë për ti ofruar PZAP-it.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës të ankuesit, në kuptim të nenit 115.1 të LZP – së, PZAP – i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 41/2017 më datën 06.06.2017.



Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi